z. Haci Mazrek, me numër personal [redacted]7 është zgjedhur Anëtar i Kuvendit Komunal në zgjedhjet për Kuvendin e Komunës 2025. Pas zgjedhjes, më datën 05.12.2025 ai ka dhënë betimin si Anëtar i Kuvendit Komunal në Mamushë, me ç'rast fillon ushtrimi i mandatit të tij. Për këtë arsye, i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave.

Neni 2

Obligohet- NjMBNj që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të përfshirjes së tij në listë të pagave, sipas legjislacionit në fuqi, me klasën e pagës Y39-CD_72, koeficient 6.30, nga blloku kodues 10/626/16914/0111.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z. Haci Mazrek, me numër personal [redacted]7, është zgjedhur Anëtar i Kuvendit Komunal në zgjedhjet për Kuvendin e Komunës 2025. Më datën 05.12.2025, i njëjti ka dhënë betimin si Anëtar i Kuvendit Komunal në Mamushë, duke filluar zyrtarisht ushtrimin e mandatit të tij. Duke qenë se betimi dhe fillimi i mandatit kanë ndodhur, z. Haci Mazrek duhet të përfshihet në listën e pagave.

Andaj, bazuar në Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave si Anëtar i Kuvendit Komunal në Mamushë.

Me këtë vendim njoftohet :

- NjMBNJ
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOSOVA CUMHURIYETI - REPUBLIKA E KOSOVO
MAMUŞA BELEDİYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 252-25
Tarih/Dt. 09.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

ZYRA E KRYETARIT
02 Nr. 252-25
Me 09.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me nenin 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008 ,Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E PERSONIT KONTAKTUES

I.

Z. **Labinot Muhaxheri**, me detyrë Inspektor, me këtë vendim caktohet **person kontaktues** nga Komuna e Mamushës me Ministrinë e Arsimit dhe Teknologjisë, lidhur me projektin e **ndërtimit të Kopshtit në Komunën e Mamushës.**

II.

Detyrat dhe përgjegjësitë: Zyrtari i caktuar do të shërbejë si pikë kontakti ndërmjet Komunës së Mamushës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë, për koordinimin e të gjitha veprimeve që lidhen me realizimin e projektit për ndërtimin e Kopshtit në Komunën e Mamushës.

III.

Personi kontaktues do të bashkëpunojë ngushtë me zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë, si dhe me Operatorin Ekonomik të përzgjedhur për realizimin e punimeve në ndërtimin e objektit të Kopshtit në Komunën e Mamushës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Z. Labinot Muhaxheri
2. MASHT
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Dalëse - Izlazni - Outgoing
02 No. 251-25
Datë/Dt. 05.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 251 -25
Me 05.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 9 dhe 72A të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me nenin 26, 44, 45, 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
"Për caktimin e komisionit për Pranimin e furnizimeve"

1.Caktohet komisioni për pranimin e furnizimeve sipas kontratës me titull ***"FURNIZIM ME GJENERATOR DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINISTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)"*** – me nr. Identifikues 626-25-9497-1-2-1/C194 dhe nr. të Brendshëm 626-25-009-1-2-1.

Komisioni do të jetë në këtë përbërje:
1.1. Mirat Morina– Kryesues i komisionit
1.2. Faruk Taç – Anëtar
1.3. Ramiye Şala – (Anëtare nga ekipi i Auditimit Social)

2. Komisioni për pranimin e furnizimeve ka përgjegjësi që të bëjë konstatimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës së furnizimeve të pranuara, të cilat dokumentohen me procesverbal se janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblerjen sipas projektit ***"FURNIZIM ME GJENERATOR DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINISTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)"*.**

3. Obligohet Komisioni për pranimin e furnizimeve që këto pranime ti bëjë duke u bazuar në kontratën me titull të ***"FURNIZIM ME GJENERATOR DHE PAJISJE ELEKTRIKE PËR PASTRIMIN E DYSHEMEVE PËR OBJEKTET KOMUNALE (ADMINISTRATË, ARSIM DHE SHËNDETËSI)"*** – me nr. Identifikues 626-25-9497-1-2-1/C194 dhe nr. të Brendshëm 626-25-009-1-2-1.
4.Komisioni për pranimin e furnizimeve shërbimeve dhe punëve në do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe të bëj pranimin e furnizimit sipas njësisë kërkuese

5. Komisioni duhet të hartoj një raport për zyrën e Prokurimit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.

7. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet:
1. Drejtoria përkatëse
2. Zyra e Prokurimit dhe
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02-250-25
Tarih/Dt. 04.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 250 /25
Me 04.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për pagesën e Kontrollit Teknik
Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I), sipas fletëpagesës nr. **5762/25**, për shërbimin e kontrollit teknik të automjetit të tipit IVECO ls55W2EA me targa 112-128-04, dhe numër të shasisë ZCFD55C8005980884.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria "Mallra dhe Shërbime", sipas përshkrimit, "Kontrolli Teknik" i Automjetit Toyota 4x4 RUNER 3.0, dhe targa IVECO ls55W2EA me targa 112-128-04" në shumën 50.00 €, për përfituesin: KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I) Numri unik i biznesit: **810630774**, Llogaria bankare 1502040000518539.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet t'i nënshtrohen rregullisht kontrollit teknik, në përputhje me dispozitat ligjore për sigurinë në komunikacion dhe funksionalitetin teknik të mjeteve motorike. Automjeti i tipit IVECO LS55W2EA me targa 112-128-04 dhe numër të shasisë ZCFD55C8005980884, është pjesë e automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës që është në shërbim të Njësisë së Zjarrfikësve në Komunën e Mamushës. Kryerja e kontrollit teknik është obligim ligjor dhe parakusht për regjistrimin dhe qarkullimin e ligjshëm të automjetit, andaj realizimi i pagesës për këtë shërbim është i domosdoshëm dhe urgjent.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria e Shërbimeve Publike
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No. 249-25
Datë/Dt. 04.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 249 /25
Me 04.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për pagesë retroaktive të shtesës së Kujdestarisë

Neni 1

z. Kenan Morina me numër personal 1070002007 me pozitë Infermier në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, i bëhet pagesa retroaktive të shtesës së Kujdestarisë për muajin tetor të vitit 2025 në shumën e përgjithshme prej 191.60 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartëpërmenduri kompenzohet në mënyrë retroaktive të shtesës së Kujdestarisë sipas nën programit 10/626/73850/0720.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit

A R S Y E T I M

Lista e punëtorëve të stafit shëndetësor për shtesat e kujdestarisë për muajin tetor 2025 është dorëzuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, për infermierin z. Kenan Morina nuk është ekzekutuar pagesa e shtesës së kujdestarisë, përkundër faktit se ai ka qenë i përfshirë në listën zyrtare të dorëzuar.

Për këtë arsye, është e domosdoshme të bëhet pagesëa e tij në mënyrë të rregullt dhe retroaktive, në pajtim me dokumentacionin e paraqitur.

Me këtë vendim njoftohet :

- DSHMS
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 248-25
Tarih/Dt. 04.12.2025

Nr.02/248-25
Datë: 04.12.2025

Në bazë të nenit 62 pika 60.3 të Ligit për vetëqeverisje Lokale NR.03/L-040, Ligjit të Punës nr.03/L-212, neni 59 (kompensimi i pushimit mjekësor) si dhe mbështetur në Udhëzuesin për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nr.2-2531 të datës 27.08.2024 (MASHT), kërkesën e mësimdhënëses Salaydin Taçi e datës 19.08.2025 të parashtruar tek Drejtori i Shkollës ANADOLU raporti i Drejtorit të Shkollës me nr të prot **72/25** e datës 19.08.2024 të dorëzuar në DKA, Raporti nga konsulta mjekësore me numër të protokolli 2662 e datës 13.08.2025 nga reparti mjekësor Klinika e Nefrologjisë.

V E N D I M

Neni 1

Aprovohet: Kërkesa e z.Salaydin Taçi mësimdhënës pranë SHFMU "ANADOLU" për shfrytëzimin e të drejtës së tij bazuar në Udhëzuesin për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nr.2-2531 të datës 27.08.2024 (MASHT).

Neni 2

Pagesa bëhet me 100% të pagës bazë për një gjysëm vjetor shkollor, në pagë përfshihet shtesa për përvojën e punës, kurse shtesat dhe kualifikimi nuk përfshihen.

Neni 3

Ky vendim mund të shfuqizohet me kërkes të palës, apo me rastin e përmisimit të gjendjes shëndetësore të Mësimdhënësit Salaydin Taçi.

Neni 4

Kohëzgjatja e vendimit është për aq sa zgjat periudha e gjysëmvjetorit shkollor.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Bazuar në procesverbalin mjekësor – Raporti nga konsulta mjekësore me numër protokolli 2662, i datës 13.08.2025, nga reparti mjekësor, Klinika e Nefrologjisë, mësimdhënësi **Salaydin Taçi** ka kërkuar të shfrytëzojë benefitet që rrjedhin nga Udhëzuesi për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nr. 2-2531, datë 27.08.2024 (MAShT).

Pas konsultave të tjera dhe bazuar në raportet e mjekut specialist, është konstatuar se tek i njëjti paraqitet kufizim i theksuar në aftësinë për punë.

Andaj, bazuar në Ligjin e Punës dhe në Udhëzuesin për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nr. 2-2531, datë 27.08.2024 (MAShT), mësimdhënësi Salaydin Taçi, mësimdhënës në SHFMU "ANADOLU" në Komunën e Mamushës, lirohet nga puna me pagesë 100% të pagës për periudhën prej një gjysmëvjetori shkollor, bazuar në pikën 4 të udhëzuesit të sipërpërmendur. Shtesa për kualifikim nuk paguhet.

Raportet mjekësore dhe raporti specialistik kanë konstatuar gjendje jo të mirë shëndetësore për mësimdhënësin dhe njëkohësisht e kanë rekomanduar si TË PAAFTË PËR PUNË.

Bazuar në dokumentacionin mjekësor (procesverbali mjekësor), në Ligjin e Punës dhe në udhëzuesin e lartcekur, Drejtoria e Arsimit e liron mësimdhënësin Salaydin Taçi nga puna për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2024/2025.

Nëse gjatë kësaj periudhe mësimdhënësit i përmirësohet gjendja shëndetësore, ai mund të kthehet në vendin e tij të punës, bazuar në raportin mjekësor dhe sipas pikës 2, nën-pika 2.8 të Udhëzuesit.

Në rast se, pas përfundimit të gjysmëvjetorit për të cilin është liruar sipas këtij vendimi, gjendja e rënduar shëndetësore vazhdon, atëherë mësimdhënësi duhet të paraqesë sërish dokumentacionin mjekësor (procesverbalin mjekësor të QKMF-së), në mënyrë që të vazhdojë lirimi nga puna edhe për një gjysmëvjetor tjetër, gjithmonë duke u bazuar në raportet mjekësore dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Me vendin njoftohen:

- Pala,
- Shkolla
- Zyra e pagesave në DKA.
- Arkivi i DKA-së

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 247-25
Tarih/Dt. 04.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŞA BELEDİYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

ZYRA E KRYETARTI TË KOMUNËS

02 Nr247 **/25**
Me 04.12.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës NR.21/18 shtator 2023 , lidhur me nenin 20, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil dhe Rregullore (QRK) nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, lidhur me nenin 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me këtë:

V E N D I M
Për formimin e Komisionit të pranimit për pozitat të kategorisë profesionale

Neni I
Formohet: Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil në pozitën të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës.

Neni II
Komisioni i Pranimit n; pajtim me nenin I të këtij vendimi përbëhet nga:

1. znj. Fitore Bytyçi- Kryesuese Zyrtare e Lartë në NJMBNJ
2. znj. Esra Osi - anëtare Shefe e Sektorit DPUGJK
3. z. Skender Sala- anëtar- Udhëheqës i Sektorit në Administratën e Përgjithshme
4. z. Çabej Nurkollar- Zyra Ligjore e Komunës së Mamushës
5. z. Aziz Elshani– Anëtar Zyrtar i Lartë Financiar.

Në përbërje të Komisionit caktohen edhe **anëtar rezervë**, të cilët do të zëvendësojnë ndonjë nga anëtarët e rregullt në rast mungese, sipas nevojës:

- z. Labinot Muhaxheri – Anëtare Rezervë, Inspektor i Tregut.
- z. Mehmet Morina- Anëtar Rezervë, Zyrtar i Lartë i Prokurimit
- z. Erhan Taç- Anëtar Rezervë, Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative
- z. Suna Morina- Anëtare Rezervë- Zyrtare Ligjore

Neni III
Komisioni i pranimit si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës.

Neni IV

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil dhe Rregullore (QRK) nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kryetar i Komunës së Mamushës

Abdülhadi KRASNIÇ

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 246-25
Tarih/Dt. 03.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 246 /25
Me 03.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për pagesën e Kontrollit Teknik
Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I), sipas fletëpagesës nr. **5758/25**, për shërbimin e kontrollit teknik të automjetit të tipit Toyota 4x4 RUNER 3.0 me targa 04Z-14-32, dhe numër të shasisë KZN1850064143.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria "Mallra dhe Shërbime", sipas përshkrimit, "Kontrolli Teknik" i Automjetit Toyota 4x4 RUNER 3.0, dhe targa 04Z-14-32, me numër të shasisë KZN1850064143" në shumën 30.00 €, sipas bllokut kodues: 21/626/16314/13954//00000/0133, për përfituesin: KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I) Numri unik i biznesit: **810630774**, Llogaria bankare 1502040000518539.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet t'i nënshtrohen rregullisht kontrollit teknik, në përputhje me dispozitat ligjore për sigurinë në komunikacion dhe funksionalitetin teknik të mjeteve motorike. Automjeti i tipit Toyota 4x4 RUNER 3.0 me targa 04Z-14-32 dhe numër të shasisë KZN1850064143, është pjesë e automjeteve zyrtare Komunës së Mamushës që është në shërbim të Njësisë së Zjarrfikësve në Komunën e Mamushës. Kryerja e kontrollit teknik është obligim ligjor dhe parakusht për regjistrimin dhe qarkullimin e ligjshëm të automjetit, andaj realizimi i pagesës për këtë shërbim është i domosdoshëm dhe urgjent.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria e Shërbimeve Publike
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazni - Outgoing
No.Nr. 02 245-25
Tarih/Dt. 01.12.2025

02 Nr. 245/25
Me 01.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për hyrje në listë të pagave dhe pagesën retroaktive

Neni 1

z. Kenan Morina, me numër personal [redacted], i cili sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës, gjegjësisht nga Drejtoria e Arsimit, për pozitën Bibliotekist, është përzgjedhur fitues i konkursit në fjalë. Më datën 18.11.2025, i njëjti ka nënshkruar kontratën e punës me numër protokolli 02.Nr.0198-25, të datës 18.11.2025, me titull të pozitës Bibliotekist në "SH.M.L. ATATÜRK".

Neni 2

Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të përfshirjes së tij në listë të pagave në bazë të kontratës me numër protokolli 02.Nr.0198-25, të datës 18.11.2025, sipas legjislacionit në fuqi, me klasën e pagës E23, koeficient 5.90, nga blloku kodues 10/626/94591/0922.

Neni 3

Obligohet- Drejtoria Komunale e Arsimit që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës për ekzekutimin e pagesës retroaktive nga data 18.11.2025 deri më 30.11.2025, në shumën prej 281.23 €, në pajtim me kontratën dhe afatet e listave të pagave.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z. Kenan Morina me numër personal [redacted]ka aplikuar në konkursin me titull të pozitës Bibliotekist në "SH.M.L "ATATÜRK", në të cilin është përzgjedhur fitues i konkursit. Në vazhdim, me datën 18.11.2025, i njëjti ka nënshkruar kontratën e punës me numër protokolli 02.Nr.0198-25, të datës 18.11.2025, me titull të pozitës Bibliotekist në SH.M.L "ATATÜRK"

Për të lartcekurin duhet të bëhet edhe pagesa retroaktive nga data 18.11.2025 deri më 30.11.2025, në shumën prej 281.23 €, pasi që ai ka nënshkruar kontratën e punës më 18.11.2025, ndërsa ndryshimet në listën e pagave bëhen deri më datën 10 të çdo

muaji. Për këtë arsye, duhet të bëhet ekzekutimi i pagesës retroaktive në shumën e cekur në nenin 3 të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave.

Me këtë vendim njoftohet :

- DKA
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 244-25
Tarih/Dt. 01.12.2025

02 Nr. 244/25
Me 01.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave dhe pagesën retroaktive

Neni 1

z. Şakir Mazreku, me numër personal [redacted]4, i cili sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës, gjegjësisht nga Drejtoria e Arsimit, për pozitën Bibliotekist, është përzgjedhur fitues i konkursit në fjalë. Më datën 18.11.2025, i njëjti ka nënshkruar kontratën e punës me numër protokolli 02.Nr.0199-25, të datës 18.11.2025, me titull të pozitës Bibliotekist në "SH.F.M.U "ANADOLU".

Neni 2

Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të përfshirjes së tij në listë të pagave në bazë të kontratës me numër protokolli 02.Nr.0198-25, të datës 18.11.2025, sipas legjislacionit në fuqi, me klasën e pagës E23, koeficient 5.90, nga blloku kodues 10/626/93391/0912.

Neni 3

Obligohet- Drejtoria Komunale e Arsimit që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës për ekzekutimin e pagesës retroaktive nga data 18.11.2025 deri më 30.11.2025, në shumën prej 281.23 €, në pajtim me kontratën dhe afatet e listave të pagave.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z. Şakir Mazreku, me numër personal [redacted] ka aplikuar në konkursin me titull të pozitës Bibliotekist në "SH.F.M.U "ANADOLU" në të cilin është përzgjedhur fitues i konkursit. Në vazhdim, me datën 18.11.2025, i njëjti ka nënshkruar kontratën e punës me numër protokolli 02.Nr.0199-25, të datës 18.11.2025, me titull të pozitës Bibliotekist në "SH.F.M.U "ANADOLU"

Për të lartcekurin duhet të bëhet edhe pagesa retroaktive nga data 18.11.2025 deri më 30.11.2025, në shumën prej 281.23 €, pasi që ai ka nënshkruar kontratën e punës më 18.11.2025, ndërsa ndryshimet në listën e pagave bëhen deri më datën 10 të çdo

muaji. Për këtë arsye, duhet të bëhet ekzekutimi i pagesës retroaktive në shumën e cekur në nenin 3 të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave.

Me këtë vendim njoftohet :

- DKA
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Ofiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 243-25
Data/Dt. 01.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

ZYRA E KRYETARIT
02 Nr. 243/25
Me 01.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës, kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M
Për ndryshim në Listën e Pagave

Neni 1

Me anë të këtij vendimi, bëhet ndryshimi në listë të pagave të ish Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Mamushë, z. Necmedin Morina me numër personal [redacted], ndryshimi në listë të pagave bëhet nga Kryesues i Kuvendit Komunal në Anëtar i Kuvendit Komunal, kjo për shkak të përfundimit të mandatit dhe ri-zdhjes së tij si anëtar i Kuvendit Komunal.

Neni 2

Obligohet- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndyshimin në listë të pagave për z. Necmedin Morina.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.12.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

Ndryshimi i statusit të z. Necmedin Morina në listën e pagave të Komunës së Mamushës, nga Kryesues i Kuvendit Komunal në Anëtar të Kuvendit Komunal, bëhet si rezultat i përfundimit të mandatit të tij në pozitën e Kryesuesit dhe ri-zgjedhjes së tij si anëtar i Kuvendit Komunal në përbërjen e re të institucionit. Përfundimi i mandatit në funksionin e mëparshëm dhe ushtrimi i një funksioni të ri kërkon domosdoshmërisht përditësimin e të dhënave në listën e pagave, në mënyrë që kompensimi i tij financiar të jetë në përputhje me pozitën dhe përgjegjësitë aktuale.

Ky veprim bazohet në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe në rregulloret përkatëse që rregullojnë administrimin dhe harmonizimin e listës së pagave në institucionet publike. Ndryshimi synon të pasqyrojë saktë gjendjen juridike dhe funksionale të zyrtarit, të sigurojë menaxhim të drejtë dhe të përgjegjshëm të mjeteve buxhetore dhe të

përforcojë transparencën dhe llogaridhënien e administratës komunale në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Kjo masë ka për qëllim të pasqyrojë në mënyrë të saktë dhe të ligjshme gjendjen faktike të marrëdhënies së tij të punës, si dhe të sigurojë menaxhim të përgjegjshëm të shpenzimeve buxhetore të Komunës.

Ndërmarrja e këtij veprimi administrativ siguron përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së administratës komunale, duke garantuar menaxhim të drejtë, efikas dhe profesional të burimeve njerëzore dhe financiare të Komunës së Mamushës.

Njoftohen
1. NjMBNj.
2. MAPL
3. Thesari
4. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 242-25
Tarih/Dt. 01.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

ZYRA E KRYETARIT
02 Nr. 242/25
Me 01.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës, kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M
Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1

Me anë të këtij vendimi, nënkryetari për komunitete në Komunën e Mamushës, z. Ramadan Zogaj me numër personal 1[redacted], i emëruar me vendim të Kuvendit Komunal me numër protokolli 01.Nr.012-22, të datës 31.03.2022, largohet nga lista e pagave për shkak të përfundimit të mandatit si nënkryetar për Komunitete në Komunën e Mamushës.

Neni 2

Obligohet- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për largimin e z. Ramadan Zogaj nga lista e pagave dhe përditësimin e të dhënave në sistemin administrativ përkatës.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.12.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

z. Ramadan Zogaj, i cili ka ushtruar detyrën e Nënkryetarit për Komunitete në Komunën e Mamushës, pas certifikimit të rezultateve zgjedhore dhe marrjes së mandatit të ri nga Kryetari i Komunës, duhet të largohet nga lista e pagave për shkak të përfundimit të mandatit të tij.

Në pajtim me këtë vendim, mandati dhe emërimi i tij përfundojnë me datën 01.12.2025, duke përmbyllur kështu detyrimet dhe përgjegjësitë e tij në këtë funksion.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe në rregulloret dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë administrimin dhe përditësimin e listës së pagave, organet kompetente të Komunës së Mamushës janë të obliguara të ndërmarrin veprimet e nevojshme për largimin e z. Ramadan Zogaj nga lista e pagave.

Kjo masë ka për qëllim të pasqyrojë në mënyrë të saktë dhe të ligjshme gjendjen faktike të marrëdhënies së tij të punës, si dhe të sigurojë menaxhim të përgjegjshëm të shpenzimeve buxhetore të Komunës.

Ndërmarrja e këtij veprimi administrativ siguron përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së administratës komunale, duke garantuar menaxhim të drejtë, efikas dhe profesional të burimeve njerëzore dhe financiare të Komunës së Mamushës.

Njoftohen
1. NjMBNj.
2. MAPL
3. Thesari
4. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 241-25
Tarih/Dt. 01.12.2025

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

ZYRA E KRYETARIT
02 Nr. 241 /25
Me 01.12.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës, kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M
Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1
Me anë të këtij vendimi ish Anëtarët e Kuvnedit Komunal në Mamushë largohen nga lista e pagave për shkak të përfundimit të mandatit të tyre si anëtar të Kuvendit Komunal në Mamushë.

Neni 2
Anëtartë që largohen nga lista e pagave janë:

1) Buyar Mazrek me numër personal [redacted]
2) Çamil Mazrek me numër personal [redacted]
3) Cevdet Ozdilmen me numër personal [redacted]
4) Halim Sadiku me numër personal [redacted]
5) Hasan Kruezi me numër personal [redacted]
6) Hatice Mazrek me numër personal [redacted]
7) Naser Morina me numër personal [redacted]
8) Oznur Taç me numër personal [redacted]
9) Sengul Mazrek me numër personal [redacted]
10) Sevgi Mazrek me numër personal [redacted]

Neni 3
Nga lista e pagave largohet edhe Anëtarja e Komitetit për Komunitete, Adisa Sadiku, me numër personal 1241397226, për shkak të përfundimit të mandatit të saj si anëtare e Komitetit për Komunitete.

Neni 4
Obligohet -Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për largimin nga lista e pagave të personave të përmendur në nenin 2 të këtij vendimi dhe të përditësojë të dhënat në sistemin administrativ përkatës

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.12.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ARSYETIM

Pas përfundimit të mandatit si Anëtar i Kuvendit Komunal në Mamushë dhe pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, obligohen organet kompetente të Komunës që, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë administrimin dhe përditësimin e listës së pagave, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për largimin e personave të përmendur më lartë nga lista e pagave.

Kjo masë ndërmerret me qëllim të pasqyrimit të gjendjes faktike dhe juridike të marrëdhënies së punës, si dhe të sigurimit që shpenzimet buxhetore të Komunës të menaxhohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Veprimi administrativ kontribuon në transparencën dhe llogaridhënien e administratës komunale, duke garantuar menaxhim të drejtë, të rregullt dhe efikas të burimeve njerëzore dhe financiare të Komunës së Mamushës.

Njoftohen
1. NjMBNj.
2. MAPL
3. Thesari
4. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 02 240-25
Tarih/Dt. 01.12.2025

02 Nr. 240-25
Datë: 01.12/2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me Ligjin nr. 03/l-212 të Punës, dhe nenin 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për Ndalimin e pagës

Neni 1

znj. Sihana Uka me numër personal [redacted], e punësuar në Udhëheqëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mamushës, ka realizuar lindjen më datë 24.11.2025 dhe ka kaluar në pushim të lehonisë nga kjo datë, gjë që është vërtetuar me dokumentacion përkatës nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren.

Neni 2

Punonjësja ka dorëzuar kërkesën për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë më 01.12.2025. Megjithatë, lindja ka ndodhur më 24.11.2025, pra pas datës 10 nëntor, datë pas së cilës nuk lejohen ndryshime në listën e pagave për muajin nëntor. Për këtë arsye, nuk ka qenë e mundur të ndryshohej paga për muajin nëntor 2025 në sistem. Si pasojë, paga për muajin nëntor është paguar e plotë, në vend të 70% të pagës bazë, siç parashikohet me nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

Neni 3

Për pasojë, nga paga e muajit dhjetor 2025 duhet të bëhet ndalesa në shumën prej 62.83€, me qëllim që paga të harmonizohet me përqindjen që i takon të punësuarës sipas legjislacionit në fuqi për pushimin e lehonisë.

Neni 4

Obligohet- Njësia për Burime Njerëzore që të ndërmer veprimet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi dhe zbatimin e ndalesës së përcaktuar në nenin 3 të këtij vendimi.

Neni 5

Kjo ndalesë zbatohet vetëm për muajin dhjetor të vitit 2025, me qëllim të balancimit të pagës së muajit nëntor, gjatë të cilit është realizuar pagesa e plotë për shkak se lindja ka ndodhur më datë 24.11.2025 dhe ndryshimet në listën e pagave bëhen vetëm deri më datë 10 të çdo muaji. Pas këtij muaji, paga e punonjëses do të vazhdojë të ekzekutohet në përputhje me legjislacionit në fuqi, konkretisht 70% e pagës bazë për periudhën e mbetur të pushimit të lehonisë.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Znj. Sihana Uka më datë 01.12.2025 ka parashtruar kërkesën për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, ndërkohë që lindja ka ndodhur më datë 24.11.2025 dhe pushimi ka filluar të realizohet nga kjo datë. Për shkak se procedurat administrative për përditësimin e listës së pagave mund të kryhen vetëm deri më datën 10 të çdo muaji, njoftimi dhe kërkesa e paraqitur më 01.12.2025 kanë ardhur pas afatit zyrtar të paparë për ndryshime në listë të pagave. Si rrjedhojë, nuk ka qenë e mundur të realizohet përditësimi i statusit të punonjëses për muajin Nëntor 2025 dhe, si pasojë, paga për këtë muaj është ekzekutuar në vlerën e plotë, ndonëse në përputhje me legjislacionin për pushimin e lehonisë punonjëses i takon pagesa prej 70% të pagës bazë.

Në bazë të rishikimit të të dhënave, zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës dhe detyrimit për harmonizimin e pagesave me periudhën aktuale të pushimit të lehonisë, rezulton e nevojshme që tejpagimi i realizuar për muajin Nëntor të korrigjohet. Kjo do të zbatohet përmes ndalesës në shumën prej 62.83 € nga paga e muajit Dhjetor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe rregullat financiare në fuqi që rregullojnë kompensimet dhe balancimet në raste të tilla.

Pas muajit dhjetor, paga e punonjëses do të vazhdojë të ekzekutohet në përputhje me legjislacionit në fuqi, konkretisht 70% e pagës bazë për periudhën e mbetur të pushimit të lehonisë.

Njoftohen
- NJMBNJ
- Thesari-MFPT
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdühadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 Nr. 239-25
Tarih/Dt. 01.12.2025

02 Nr. 239 -25
Me 01.12 2025

Në bazë nenit 13 dhe 58 paragrafi 1 pika (b) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 21 të Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët Publik, Nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenit 13 të Rregullore (QRK) nr. 04/2024 Për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 01/2018 Për Rregullimin e Procedurave Administrative të Kompensimit Për Pushimin e Lehonisë të Paguar nga Qeveria, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M
Për Pushim të Lehonisë

Neni 1

znj. Sihana Uka, me numër personal 1231919810, e punësuar në pozitën Udhëheqëse e Menaxhimit të Personelit në Komunën e Mamushës, i miratohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajsh, duke filluar nga data **24.11.2025** deri më **24.11.2026**.

Neni 2

Pagesa për gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë, nga data **24.11.2025** deri më **24.05.2026**, do të bëhet nga punëdhënësi në lartësi prej 70% të pagës bazë, nga mjetet buxhetore të institucionit ku e punësuara është në marrëdhënie pune.

Neni 3

Pagesa për tre (3) muajt në vijim, nga data **24.05.2026** deri më **24.08.2026**, do të bëhet nga Qeveria e Kosovës, në lartësi prej 50% të pagës mesatare në Kosovë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

E punësuara ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të shfrytëzojë edhe tre (3) muaj pushim të papaguar, duke filluar nga data **24.08.2026** deri më **24.11.2026**.

Neni 5

Ky vendim fillon te prodhon fuqi Juridike nda data nënshkrimit.

A R S Y E T I M

znj. Sihana Uka, me numër personal 1231919810, e punësuar në pozitën Udhëheqëse e Menaxhimit të Personelit në Komunën e Mamushës, ka lindur më datë 24.11.2025, lindje e cila është vërtetuar me fletëlëshim nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në

Prizren, me numër protokolli 2164, të lëshuar nga Departamenti për Nëna dhe Fëmijë – Reparti i Neonatologjisë.

Pas përfundimit të pushimit të lehonisë të paraparë me nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe paragrafin 1 të nenit 13 të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, e punësuara është e obliguar të kthehet në vendin e punës.

Nëse e punësuara nuk dëshiron ta shfrytëzojë të drejtën e pushimit të lehonisë sipas pikës II dhe III të këtij vendimi, ajo duhet të njoftojë punëdhënësin jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të pushimit sipas pikës I të këtij vendimi. Gjithashtu, edhe nëse e punësuara nuk i shfrytëzon pushimet sipas pikës II dhe III, ajo gëzon të drejtën e ushqyerjes së foshnjës me qumësht gjiri, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, vendoset si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 30 ditësh, në **Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa** të Komunës së Mamushës.

Me këtë vendim njoftohet:

- **znj. Sihana Uka;**
- Personeli
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç